



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1300/4 Prot.

Tiranë, më 09.10.2024

VENDIM

Nr. 10, datë 09.10.2024

**PËR
MIRATIMIN E PROGRAMEVE AKTIVE DHE JOAKTIVE TË STUDIMIT, TË
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR", NË FAKULTETET E
UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 3, në nenin 38 dhe në nenet 70, 71 dhe 73 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Urdhrin e Përbashkët nr. 112, datë 05.07.2024 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2024", në nenin 24 të Statutit të Universitetit të Arteve, në shkresat e Fakultetit të Muzikës nr.1300/3 prot., datë 08.10.2024, të Fakultetit të Artit Skenik nr. 1300/1 prot., datë 08.10.2024, të Fakultetit të Arteve të Bukura nr. 1300/2, datë 08.10.2024, pasi i shqyrtoi dhe diskutoi, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e programeve të paaktivizuara të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" për vitin akademik 2024-2025 në Fakultetin e Muzikës, sipas shkresës së fakultetit bashkëngjitur:
 - a. Kontrabas;
 - b. Kitarë;
 - c. Oboe;
 - d. Fagot;
 - e. Trombë;
 - f. Trombon;
 - g. Bastubë.
2. Në Fakultetin e Artit Skenik dhe në Fakultetin e Arteve të Bukura, për vitin akademik 2024-2025, për ciklin e parë të studimeve "Bachelor", të gjitha programet e studimit janë aktive, sipas shkresave të fakultetit bashkëngjitur.



3. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, QSHA-së si dhe t'i njoftohet studentëve të regjistruar në këto programe.

4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA

Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

Nr. 1300/3
Prot.

Tiranë, më 08/10/2024

Lënda: Përgjigje shkresës Tuaj nr.1300, datë 07.10.2024

Prof. Asoc. Dorian ÇENE
ZËVENDËSREKTOR
Universiteti i Arteve
Sheshi "Nënë Tereza"

Bazuar në Urdhrit të përbashkët Nr. 112 datë 05.07.2024, "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2024-2025", në Fakultetin e Muzikës nuk janë aktive programet për vitin akademik 2024-2025 si më poshtë:

- Kontrabas
- Kitarë
- Oboe
- Fagot
- Trombë
- Trombon
- Bastubë

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DEKANI




Prof. Arben Llozi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANI

Nr. 1300/prot.

Tiranë, më 08/10/2024

Lënda: Përgjigje shkreses 1300 datë 07.10.2024.

ZV/ REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE

Prof.Asoc Dorian ÇENE

Zoti Zv,Rektor,

Referuar shkresës tuaj me nr. 1300 Prot, datë 07/10/2024, ju bëjmë me dije se në Fakultetin i Artit Skenik në Ciklin e Parë "Bachelor" nuk ka program që nuk aktivizohet për vitin akademik 2024-2025.

Ju faleminderit,

Prof. Miltiadin KUTALI

DEKAN I FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA
DEKANI

Nr. 1300/2 prot.

Tiranë, më 08/10/2024

Lënda: Kthim përgjigje për shkresën me nr.1300 prot., dt. 7.10.2024

Zv/Rektorit, Prof. Asc. Dorian ÇENE

Bazuar në shkresën tuaj me nr.1300 prot., dt. 7.10.2024 si dhe Udhërit të Përbashkët Nr.112, dt. 05.07.2024, "Për miratimin e Kalendarit për Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në Intitucionet e Arsimit të Lartë, për Vitin Akademik 2024-2025", Kreu II, Ju bëjmë me dije se në Fakultetin e Arteve të Bukura të gjitha programet e Ciklit të Parë të Studimeve do të jenë aktivë gjatë vitit akademik 2024-2025.

Programet si më poshtë vijojnë:

1. Pikturë Grafikë
2. Pikturë Multimedia
3. Pikturë Tekstil dhe Modë
4. Fotografi
5. Pikturë Kavaleti
6. Pikturë Monumentale
7. Skulpturë
8. Skulpturë Qeramikë



PROF. SADIK SPAHIJA

DEKAN

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA